




**MIRATOHET
SEKRETAR I KTKM
JOLI MITROJORGJI**

SPECIFIKIME TEKNIKE

**“RESTAURIM I MUREVE ANTIKE TË ZBULUARA PRANË SHKOLLËS “EFTALI KOÇI”
DHE REHABILITIM I HAPESIRES PERRETH”**

Grupi i projektimit:

Ronela Çuku
Elina Manushi
Esfrosina Koçi
Regiana Hida



Çdo ndërhyrje e propozuar duhet të jetë në përputhje me Projektin e miratuar në KKTKM si dhe konfirmo VKM nr. 1099, datë 24.12.2020; *“Për miratimin e mënyrave të trajtimit, normave teknike, kriterëve dhe modeleve të ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore”*.

Shpjegim i terminologjisë

“Konservim” janë të gjitha masat e ndërmarra që nuk kërkojnë ndërhyrje direkte në vepër siç janë krijimi i kushteve mjedisore (lagështi relative, temperaturë, pastërti nga ndotja atmosferike, mbrojtja nga pluhurat, dëmtimi biologjik dhe fizik në fonde, ekspozimi dhe transporti), si edhe ndërhyrjet kimike direkt në objekt apo vepër, me qëllim parandalimin e çdo lloj dëmtimi.

“Ndërhyrje” është tërësia e masave të ndërmarra dhe operacioneve të kryera në vepër, me qëllim ndalimin e degradimit të mëtejshëm dhe nxjerrjen në pah të vlerave të saj.


“Restaurimi” është vlerësimi i thelbit origjinal të monumentit nëpërmjet ndërhyrjeve për ndalimin e degradimeve të mëtejshme dhe nxjerrjen në pah të vlerave të tyre.

Ndërhyrjet në “monumentet e kulturës”

Në disa raste nevojat për konservim duhet ti paraprijnë atyre të vendosjes në siguri, në vazhdim nuk është e nevojshme të rregullohen nivelet e sigurisë të një ndërtese historike me ato ndërtesave të reja por është e mjaftueshme që nivelet e sigurisë të përmirësohen krahasuar me ato para ndërhyrjes.

Teknikat e ndërhyrjeve që do përdoren në monumentet e kulturës duhet të respektojnë karakteristikat historike, artistike, arkitektonike dhe shpërndarjen e tyre. Kjo do të thotë që përmirësimi duhet të realizohet pa prodhuar modifikime substanciale në sjelljen e strukturës dhe ndërtesës duke përdorur për sa është e mundur teknika ndërhyrje dhe metodologji operative tradicionale, konservim të materies, kushteve fizike dhe morfologjike. Teknika dhe materiale me karakter të rikthyeshëm edhe pjesor që përdoren në mënyrë diskrete, jo evazive dhe në koherencë me llogjikën konstruktive të strukturës ekzistuese.

Ky seksion përmban përcaktimet e përgjithshme dhe kërkesat për punimet e restaurimit . Më tej ajo mbulon te gjitha punimet që lidhen me realizimin sa më rigoroz të ndërhyrjeve restauruese.



SPECIFIKIMET E NDËRHRYJEVE RESTAURUESE

1.1 Transport materiale ndërtimi, dhe dhe mbeturina me auto deri në 5.0 km

Materialet që do hiqen nga objekti apo akumulimi i inerteve, dherat e lëvizura, do të hiqen në mënyrë manuale me lopatë dhe largimi i tyre nga kantieri deri te mjete i transportit do të bëhet me karro dore. Dherat e pastruar si dhe materialet inerte do të largohen nga kantieri me automjet. Transporti i çdo materiali nga Kontraktori, do të bëhet me makina të përshtatshme, të cilat kur ngarkohen nuk shkaktojnë derdhje dhe e gjithë ngarkesa të jetë e siguruar. Ndonjë makinë që nuk plotëson këtë kërkesë ose ndonjë nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do të hiqet nga kantieri.

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet për transportin e mbeturinave dhe ngarkim shkarkimi i tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia deri në 5 km larg nga kantieri.

Ky zë pune përfshin të gjitha proceset e mësipërme dhe çmimi i tij është për njësi Lekë/ m³.

1.2 Pastrimi nga bimësia e ulët në territor (R.1.8)

Ky çmim përfshin pastrimin e territorit nga bimësia e ulët. Vegjetacioni i ulët ka nevojë për ndërhyrje në të dyja ciklet e zhvillimit, pranverë dhe vjeshtë. Trajtimi i tij do të bëhet në bazë të aspektit të zhvillimit. Në strukturat ku vegjetacioni është i rrallë do të përdoret ëi mekanik i tij, duke e eliminuar vegjetacionin me githë rrënjë.

Pas eliminimit përfundimtar të vegjetacionit, është e nevojshme që të bëhet fugatimi i strukturave. (si realizohet ky proces, është trajtuar në paragrafët paraardhës).

Në rastet kur trungu/kërcelli ka diametër më të madh se 4 cm atëherë pasi të bëhet prerja do të përdoret mënyra e injektimit të herbicidit si tek pemët e larta.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m².

1.3 Konsolidim strukturor i muraturave prej guri (me dy parete dhe mbushje në mes) me teknikën e injektimit të mishelës me rezistencë të lartë mekanike dhe përbërje të ulët të kriprave të tretshme në ujë

Ky proces duhet te kryhet me shume kujdes dhe ne menyre graduale e te kontrolluar ne anet e murit ne menyre qe sapo te vihen re njolla te nderpritet menjehere deri sa te realizohet renia e llacit te hedhur dhe ngrirja e tij pasi te vazhdohet me kujdes hedhje ne sasi te vogla te llacit me renie te lire nga lart.

Përbërja e llacit pa kimikate qe demtojne pikturen. :

Rërë lumi e larë

2 pjesë



Rërë vullkanike me granulacion 0,5-1 cm	2 pjesë
Pluhur tulle e çmërçi dhe copa tulle deri në 2 cm	2 pjesë
Gëlqere e vjetër	3 pjesë

Ky proces pune përfshin konsolidim e mureve prej guri me dy parete dhe mbushje në mes.

1.4 Prishje mur tulle me pastrim (hapja e portes) (R.IV.5)

Në nurin ku është menduar të jetë hyrja për në sitin arkeologjik do të realizohet hapja dhe F.V e derës metalike. Gjithashtu prishje mur tulle do të kryhet edhe në murin perimetrat, art ku do të jetë e mundur dhe do të gjykohet e nevojshme.

Prishje e muraturës me tulla të plota ose me vrima, e çfarëdo lloji dhe dimensionit, edhe e suvatuara ose e veshur me majolikë, që realizohet me çfarëdo lloji mjeti dhe e çfarëdo lartësie ose thellësie, përfshirë skelën e shërbimit ose skelerinë, armaturat e mundshme për të mbështetur ose mbrojtur strukturat ose ndërtesat përreth, riparimi për dëmet e shkaktuara ndaj të tretëve për ndërprerjet dhe restaurimin normal të tubacioneve publike dhe private (kanalet e ujrave të zeza, ujin, dritat etj.), si dhe vënien mënjane dhe pastrimin e gurëve për përdorim, duke bërë sistemin brenda ambientit të kantierit. Gjithashtu, edhe çdo detyrim tjetër që siguron plotësisht prishjen.

Ky zë pune përfshin furnizimin e lëndës së parë si dhe të gjitha proceset e mësipërme dhe çmimi i tij është për njësi Lekë/ m³.

1.5 Germim, sistemim nivelim dheu 5-10 cm (për rrugë kalimi) (R.I.1)

Ky çmim parashikon germimin e dherave aty ku është e nevojshme dhe ku është parashikuar në projekt. Germimi i dheut do të bëhet mekanikisht.

Mbrojtja e punimeve të dheut.

Tek punimet me dheun duhet nga njëra anë të mbrohen njerëzit, të cilët nuk janë të përfshirë në ndërtimin e projektit, e nga ana tjetër duhet të mbrohen njerëzit e inkuadruar në realizimin e projektit. Mbrojtja e njerëzve të painkuadruar realizohet me rrethim (me gardh, rrjetë gabiant, etj.) i cili nuk lejon që të rrezikohen. Gjithashtu, duhet vendosur tabela paralajmëruese me të cilën ndalohet kalimi i rrethimit nga persona që nuk punojnë në projekt.

Përdorimi i materialit të gërmuar.

Materiali i përshtatshëm dhe materiali i rimbushur nga punë të përkohshme do të përdoren për rimbushje dhe nivelim. Çdo material i tepërt do të jetë në dispozicion të mungesave të materialeve të kërkuara.

Ky çmim është për njësi Lekë/m³.



1.6 Shtresë dërrasa FM 4.0 cm (R.X.24)

Dysheme me dërrasa me trashësi 40 – 45 mm, me dru lisi ose ahu të staxhionuar në mënyrë natyrale ose artificiale, e punuar mashkull dhe femër sipas skicave, me gjerësi deri 25cm, të vendosura sipas udhëzimeve në projekt, duke përfshirë armaturën e poshtme me dru pishe të seksionit 6 x 4 cm cdo 70cm, të fiksuara me mbajtëse (me vida e upa) dhe llaç çimentoje dhe të vendosura në interaks në mënyrë të rregullt.

Pas vendosjes së dyshemesë, bëhet lëmimi, stukimi dhe ilustrimi i dërrasave duke përdorur vernik special transparent.

Kjo shtresë do të përdoret në këndin “Arkeologu I vogël” dhe në rrugët e kalimit në mënyrë perimetrale.

1.7 Mbushje me rërë natyrale (R.XVI.4)

Ky zë përfshin blerjen e materialit të rërës si dhe vendosjen në vepër. Shtresa e rërës është parashikuar të vendoset në këndin “Arkeologu i Vogël”, shtresa e rërës do të lihet në formën e saj natyrale, pa ngjeshje dhe nivelim.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m³.

1.8 Fugatim muri (pastrim mekanik+larje me ujë+fugatim) (R.VI.19)

Fugatime do të kryhen në ato raste kur çarjet (fisurat) janë deri të një madhësie mesatare dhe kur vërehet se llaçi ekzistues është i degraduar. Fugatime sipërfaqësore do të aplikohen në ato raste kur çarjet janë të karakterit kapilar me qëllimin e vulosjes së tyre.

Fugatimet konsistojnë në pastrimin e llaçit ekzistues të dëmtuar.

Fugatimi do të fillojë me pastrimin mekanik (gërryerjen) të fugave nga llaçi degraduar. Pas pastrimit mekanik të fugës dhe larjes me ujë të bollshëm do të kryhet mbyllja e fugave. Masa e llaçit të përgatitur, duhet të jetë homogjen dhe uniform. Fugatimi do të kryhet me llaç gëlqere të majmë, me konsistencë të ulët. Mbasi fillon prezën llaçi, atëherë ai laget dhe fërkohet me furçë teli për të eliminuar plasaritjet eventuale të tij. Është e rëndësishme të bëhen analiza të miratuara, për të mësuar përbërjen kimiko-fizike të llaçit ekzistues në mënyrë që të përcaktosh qartësisht natyrën, prejardhjen dhe granulometrinë e materialit të përdorur. Përbërja e llaçit duhet të jetë me material analog të atij ekzistues. Përbërja e llaçit të fugave do të pranohet nga mbikqyrësi i punimeve pas provave dhe marrjes së kampionëve në vend dhe nga rezolucioni kromatik që duhet të arrihet në ngjashmëri me llaçin ekzistues. Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet për pastrimin dhe heqjen e kujdesshme të shtresës së llaçit në fugat me furçë teli të ashpër dhe largimin e mbeturinave nga objekti, transporti i materialeve dhe gjithçka duhet për përfundimin e këtij procesi.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m².



1.9 Konsolidim i kreut të murit me 1-2 rreshta gurë me llaç gëlqere 1:3 (R.21)

Ky çmim përfshin konsolidimin e kreut të murit me 1 apo 2 rreshta rrasa guresh për të plotësuar kornizen e sipërme të muratës në vendet ku ajo mungon, duke përfshirë këtu dhe fugatimin e tyre. Për plotësimin e kornizes do të përdoren rrasat e gureve ekzistuese në gjendje të mirë si dhe të tjerat do të plotësohen të njëjta me ato ekzistueset për nga përmasat dhe dimensionet.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m³

1.10 Pastrim i qemerit nga mbushja dhe llaçi i degraduar

Të bëhet pastrimi i qemerit nga materialet inerte të copëzuara, llaçi i degraduar dhe nga depozitimet e dherave në hapësirat e krijuara nga mungesa e materialit ose nga fugat midis gurëve. Pastrimi bëhet manualisht me furçë teli dhe me furçe apo fshesë. Ky proces përcaktohet në vend gjatë fazës së parë të zbatimit të punimeve nën drejtimin e Mbikqyrësit të punimeve restauruese. Nëse ku pastrim nuk bëhet në mënyrë të kujdeshme, llaçi i injektuar nuk do të kryejë funksionin e pritshëm lidhës të strukturës.

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet për pastrimin e qemereve dhe kupolave nga mbushja dhe llaçi i degraduar. Në çmim përfshihet edhe transporti i mbeturinave dhe ngarkim shkarkimi i tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia. Ky çmim është për njësi Lekë/ m².

1.11 Shtrim i rrugicave me sabilizant

- Hapi i parë i radhës së punës është germim i dheut përgjatë gjithë gjatësisë dhe gjerësisë së përcaktuar në grafik deri në thellësinë 10cm.
- Hapi i dytë i radhës së punës është vendosja e gjeotekstitit.
- Pas vendosjes së gjeotekstitit do të vendosen kufizuesit prej druri;
- Hapi i tretë i radhës do jetë shtrimi i një shtrese çakelli prej rreth 10-15 cm. dhe ngjeshja e tij.

1.12 Sherbetisje e bojatisje me gëlqere

Ky zë parashikon lysterjen me gëlqere të mureve perimetral që kufizojnë sitin arkeologjik. Fazat e ndërhyrjes:

1. Përgatitja e sipërfaqes që do të lyhet, para lysterjes duhet të bëhet kruajtja e ashpër e gëlqeres së mëparshme nga sipërfaqja e lyster, mbushja e gropave të vogla apo dëmtimeve të sipërfaqes së murit me anë të stukimit dhe bërja gati për paralysterje.



2. Paralyerja e sipërfaqes së pastruar. Në fillim të procesit të lyerjes, bëhet paralyerja e sipërfaqeve të pastruara mirë me gëlqeren e holluar (Astari). Për paralyerjen bëhet përzierja e 1 kg gëlqere me një litër ujë. Me përzierjen e përgatitur bëhet paralyerja e sipërfaqes vetëm me një dorë. Norma e përdorimit është 1 litër gëlqere e holluar duhet të përdoret për 2 m² sipërfaqe.

3. Lyerja me gëlqere e sipërfaqes. Lyerja bëhet me dy duar bojë gëlqere e stazhonuar mirë. Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve të sipërpërmendura, transportin e materialit, skeleri.
Ky çmim është për njësi Lekë/m².

Elina
Manushi

Digitally signed by Elina
Manushi
Date: 2025.03.25
14:57:47 +0200'

Ronela
cuku

Digitally signed by
Ronela cuku
Date: 2025.03.25
15:16:21 +0200'

Esfrosin
a

Digitally signed by
Esfrosina Keci
Date: 2025.03.25
15:31:03 +0200'

